



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim Konsekutiv B-A / A-B

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore; 4 kredite; 10 leksione, 30 seminare
Viti / Semestri: Viti III, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze”
Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të aftësojë studentin në rishprehjen nga ana e interpretit në gjuhën mbërritëse të një ligjërate të thënë në gjuhën e origjinalit, në minutat që vijojnë, pas fundit të ligjëratës origjinale në kushtet e duhura të teknikës mbështetëse audio, ku çdo ligjëratë përkthehet pothuajse në kohë reale përmes teknikës së mbajtjes së shënimeve. Ky kurs synon në formësimin e rrjedhshmërisë ligjërimore në gjuhën e huaj, formësimin e frymës sintetizuese dhe të aftësisë së të kuptuarit të menjëhershëm të ligjëratës së folësit edhe në rastet kur ajo është teknike ose shkencore, ndërkohë që i jep mundësi auditorit të ndjekë drejtpërsëdrejti përkthimin e ligjëratës me anë të kufjeve. Në fund të kursit studentët do jenë të aftë të: të përkthejnë thujse pak minuta më mbrapa tekstin e ligjëruar nga folësi.

Objektivat specifike lëndore:

1. Aftësi për të fituar koncepte bashkëkohore të interpretimit.
2. Aftësi për të komunikuar në situata të ndryshme mjaft të vështira.
3. Njohuri mbi fakte interpretative dhe sjelljet e interpretit.
4. Aftësi për të shprehur mendime mjaft të vështira nga ana gjuhësore.
5. Aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.
6. Aftësi për të marrë vendime dhe të mbajnë shënime sintetizuese të qarta.